

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, me objekt: *“Mbi zbatimin e procedurës ligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme, evidentimin dhe trajtimin ligjor të mbivendosjeve”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2012 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 5, datë 22.01.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 577/15, datë 22.02.2014, i ka rekomanduar zj. Elona Bici, Regjistruese e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Ministria e Drejtësisë të hartojnë draft ndryshimet e ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012 *“Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”* apo akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, në drejtim të regjistrimit në kartelat e pasurive të paluajtshme dhe certifikatat e pronësisë të objekteve me leje ndërtimore apo legalizimi të klasifikuara si ambienteve ndërtimore të pambuluar dhe konkretisht:

Argumentimi

Nga auditimi i ushtruar në ZVRPP Tiranë, në shqyrtimin e procedurave të pranimit dhe regjistrimit të lejeve të ndërtimit apo lejeve të legalizimit, kryesisht për objektet shumë katëshe janë konstatuar se nga ZVRPP veprohet vetëm në regjistrimin e truallit dhe objektit, pa përfshirë ato pjesë të objektit të cilat sipas lejes janë të pa mbuluar (kryesisht veranda).

Nga auditimi i KLSH në ZVRPP Tiranë, u konstatua gjithashtu se pavarësisht nëse janë pjesë të mbuluar apo jo këto objekte në shumicën e praktikave të kalimit të pronësisë të apartamenteve nga shoqëria sipërmarrëse të blerësit, këto sipërfaqe rezultojnë të kenë qenë pjesë e kontratës së kalimit të pronësisë dhe përgjithësisht çmimi i tyre është sa ½ e çmimit të sipërfaqes së mbuluar, por duke qenë se ZVRPP nuk ka si në referencat ligjore mbi të cilat vepron ashtu dhe në Kartelën e Pasurive të Paluajtshme nuk ka një rubrikë të veçantë për të regjistruar këto sipërfaqe, ZVRPP nuk i regjistron ato. Janë konstatuar edhe raste në të cilat ZVRPP bazuar në kërkesat e pronarëve i ka regjistruar në seksionin *“Përshkrim i veçantë”*, por që nuk përbën titull pronësor.

Aktualisht vlera e shitjes për metër/katror të një verande është sa ½ e vlerës po për një metër/katror të apartamentit, pra nëse shteti në regjistrimin e një objekti arkëton 1000 lekë për metër/katror për apartament, për veranda duhet të arkëtoj ½ e vlerës.

Për sa cituar, që këto sipërfaqe të jenë ligjërish pjesë e sendeve që janë në qarkullimin civil, pra jo më transaksione informale ndërmjet sipërmarrësve dhe blerëseve të apartamenteve apo dhe më tej ndërmjet palës shitëse dhe asaj blerëse, por dhe të shitësit të një objekti të legalizuar dhe blerësit të tij, **këto sipërfaqe duhet të regjistrohen nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.**

Regjistrimi i tyre do të shmangte konflikte sociale të mundshme, por mbi të gjitha si dhe për çdo transaksion regjistrimi të kalimit të pronësisë do të mund të krijonte të ardhura

në favor të buxhetit të shtetit, kjo si në regjistrimin e objektit ku subjektet duhet të paguajnë tarifën e regjistrimit për metër/katrorë, por dhe më tej tatimin mbi kalimin e pronësisë, për çdo transaksion të kryer.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, që në bazë të nenit 1 dhe neni 9 të ligjit nr. 9948, datë 07.7.2008 “*Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore*”, t’i kërkojë Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, verifikimin e disa AMTP dhe konkretisht në zonat kadastrale 1006 Ahmetaq, 1167 Bërxull, 1078 Baldushk, 2276 Ndroq, 9251 Pezë e Madhe dhe 3051 Priskë e Madhe.

2. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP Tiranë që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “*Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme*”, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor, të nxjerrë urdhër kufizimi për 5 pasuri të ndodhur në Zonën kadastrale 1167, Bërxull.

3. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP-së Tiranë, që në të ardhmen specialistët të hartojnë hartat treguese të regjistrimit (HTR) dhe të plotësohet formulari shtojca 3, në zbatim të pikës 4, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “*Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme*”, të ndryshuar dhe pikës 10.6, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “*Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme*”.

4. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP-së Tiranë, që në të ardhmen dokumentacion që administrohet në dosje të jetë i plotësuar me të gjitha të dhënat, në zbatim të nenit 107 pika 2 germa “dh”, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “*Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar.

5. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP-së Tiranë, që në ZK 1006, në volumnin 10 faqe 135, në KPP të vendoset numër i faqes dhe të mbyllet me vulë mbyllëse, në volumnin 10, KPP ndërmjet faqes 226 dhe 227, e lënë pa plotësuar të mbyllet me vulë mbyllëse, në volumnin 10 faqe 27, të korrigjohet KPP e plotësuar dy herë për pasuri dhe sipërfaqe të ndryshme, në zbatim të pikës 23 paragrafi 3 dhe 4, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999, pikës 1, të Udhëzimit metodik nr. 76, datë 13.09.1999 “*Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme*” dhe pikës 1.3, kreu i IV të Rregullores nr. 2079, datë 11.07.2007 “*Për arkivimin e dokumenteve tekniko ligjor në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme*”.

6. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP-së Tiranë, që në ZK 1167, në volumnin 12, KPP ndërmjet faqes 104 dhe 105, faqes 146 dhe 147, e lënë pa plotësuar të mbyllet me vulë mbyllëse. Të korrigjohen KPP për pasurinë nr. 689/23, pasurinë nr. 133/25 dhe për pasurinë nr. 546/2. Në volumnin 13, KPP ndërmjet faqes 20 dhe 21, e lënë pa plotësuar të mbyllet me vulë mbyllëse. Të hartohet inventari për çdo volum dhe regjistër hipotekar, në zbatim të pikës 23 paragrafi 3 dhe 4, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999, pikës 1, të Udhëzimit metodik nr. 76, datë 13.09.1999 dhe pikës 1.3, kreu i IV të Rregullores nr. 2079, datë 11.07.2007.

7. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP-së Tiranë, që në ZK 1078, në volumnin 4, KPP të vulosen me vulën e ZVRPP Tiranë dhe të nënshkruhen nga regjistruesi, në zbatim të pikës 23 paragrafi 3 dhe 4, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 dhe të pikës 1, të Udhëzimit metodik nr. 76, datë 13.09.1999.

8. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP-së Tiranë, që në ZK 2776, në volumnin 8, KPP nga faqja 83 deri në faqen 101 dhe faqja 112, 113, 114, 117, 199, të mbyllet me vulë mbyllëse, në

zbatim të pikës 23 paragrafi 3 dhe 4, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 dhe të pikës 1, të Udhëzimit metodik nr. 76, datë 13.09.1999.

9. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP-së Tiranë, që në ZK 2951 volumi 5, ZK 2952 volumi 3 dhe ZK 1032 volumi 1, KPP të vulosen me vulën e ZVRPP Tiranë dhe të nënshkruhen nga regjistruesi, në zbatim të pikës 23 paragrafi 3 dhe 4, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 dhe pikës 1, të Udhëzimit metodik nr. 76, datë 13.09.1999.

10. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP-së Tiranë, që në ZK 3366, volumi 40, 44, 46, 47, 50, 51, 53, 54 dhe 56, KPP të vulosen me vulën e ZVRPP Tiranë, të vendoset data përfundimtare dhe të nënshkruhen nga regjistruesi, në zbatim të pikës 23 paragrafi 3 dhe 4, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 dhe pikës 1, të Udhëzimit metodik nr. 76, datë 13.09.1999.

11. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “*Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme*”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë e ndodhura në Zonat kadastrale 1006, Ahmetaq, 1167, Berxull, 1078 Baldushk, 2776, Ndroq, 2951 Pezë e Madhe, 2952 Pezë e Vogël dhe 3426 Priskë.

Nga ZVRPP Tiranë, trojet e shtëpive të regjistruara në pronësi të subjekteve private të regjistrohen në kartelën e pasurisë së paluajtshme seksioni D “Posedim”, në zbatim të nenit 10 të Dekreti nr. 5747, datë 29.06.1978 dhe pikës 12.1, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

12. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “*Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme*”, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë e ndodhur në ZK 8210 me nr. 6/452, volum 28 faqe 17, deri në nënshkrimin dhe vulosjen e lejes së ndërtimit, në zbatim të nenit 107 pika 2 shkronja “a” dhe “e” të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, nenit 53 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” dhe pikës 1, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

13. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, që në ZK 3866, në volumin 40, 44, 46, 47, 50, 51, 53, 54 dhe 56, në KPP të vendoset datë përfundimtare të nënshkruhen nga regjistruesi dhe të vuloset me vulën e ZVRPP Tiranë, në zbatim të pikës 23 paragrafi 3 dhe 4, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 dhe pikës 1, të Udhëzimit metodik nr. 76, datë 13.09.1999.

14. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, që pasuritë e ardhura nga ALUIZNI Tiranë të mos regjistrohen në kartelat e pasurisë së paluajtshme nëse nuk kanë të përcaktuar të gjitha kufizimet sipas genplanit që i bashkëlidhet lejes së legalizimit.

15. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “*Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme*”, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor, të nxjerrë urdhër kufizimi për 9 pasuri të ndodhura në zonën kadastrale 8210.

16. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, që në zbatim të Rregullores “Për arkivimin e dokumenteve tekniko ligjore në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, Rregullores së Brendshme nr. 184, datë 08.04.1999, si dhe UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “*Për procedurat e regjistrimit në ZRPP*”, të ndryshuar, të kryejë inventarizimin e dosjeve, të konfirmohet fleta e inventarit të dosjes nga dorëzuesi (specialistët) dhe marrësi (arkivisti), si dhe të ndërpriten praktikat e deritanishme të pranimit nga arkivi të dokumenteve të cilët nuk plotësojnë kriteret tekniko-ligjore.

17. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë e ndodhur në zonën kadastrale nr. 8150, pasuria nr. 3/431-33, volum 45, faqe 105-107, të vendimit të KKKP ish-Pronarëve Tiranë, nr. 982, datë 15.12.1994, dhënë më shumë 392.⁷⁵ m².

17.1 Bashkia Tiranë dhe Avokati i Shtetit në bashkëpunim dhe mbështetur në konstatimet e bëra nga auditimi të kërkojnë në rrugë gjyqësore ndryshimin e vendimit nr. 982, datë 15.12.1994, për sa i përket pjesës së njohur, kthyer e kompensuar e cila rezulton së është përfituar padrejtësisht në dëm të interesave të pronës shtetërore.

18. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë e ndodhur në zonën kadastrale nr. 8160, regjistruar në volum 12 faqe 148, 149, 150 dhe 151 dhe në volum 25 faqet 71, 72 dhe 73, të vendimit të KKKP ish-Pronarëve Tiranë nr. 233, datë 10.7.1995 dhe nr. 1096, datë 24.09.1996, dhënë më shumë një sipërfaqe prej 3689 m².

Bazuar në konstatimin se pjesërisht mbi këto pasuri rezulton e regjistruar leje ndërtimi e regjistruar në volum 41, faqe 74-115, pasuria nr. 3/1124, Regjistruesi i ZVRPP Tiranë në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012, ZVRPP Tiranë, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë/apartamente të cilat figurojnë të regjistruara në emër të pronarëve të truallit.

18.1 Bashkia Tiranë dhe Avokati i Shtetit në bashkëpunim dhe mbështetur në konstatimet e bëra nga auditimi të kërkojnë në rrugë gjyqësore ndryshimin e vendimit nr. 233 datë 10.7.1995 dhe vendimit nr. 1096 datë 24.09.1996, për sa i përket pjesës së njohur, kthyer e kompensuar e cila rezulton së është përfituar padrejtësisht në dëm të interesave të pronës shtetërore.

19. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë ndodhur në zonën kadastrale nr. 8140, pasuria nr. 2/459, referenca nr. 14009 për të cilën rezulton se i njëjti truall është dhënë në funksion të dy objekteve, pa u kryer ndarja e tij në dy pasuri dhe pa u mbyllur kartela e truallit në funksion të pallatit, në kundërshtim me urdhrin e Kryeregjistruesit nr. 132, datë 02.06.2003.

20. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, që në zbatim të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, dhe akteve nënligjore të dala për zbatim, për pasuritë ndodhur në zonën kadastrale nr. 8380, pasuria 3/88 dhe 3/243, të zbatohet urdhri i Kryeregjistruesit përcjellë me shkresën nr. 2098/47, datë 27.04.2012.

21. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë e ndodhura në zonën kadastrale nr. 8160, të regjistruara në pasurinë nr. 6/162 e 6/163 dhe në pasurinë nr. 6/250/1 e 6/248/1, ku origjina e pronësisë është nëpërmjet kontratës së shitjes së truallit të vitit 2000 të kryer nga Bashkia Tiranë dhe leje legalizimi të vitit 2012 në kundërshtim me ligjin pasi trualli dhe objektet e legalizuara janë pjesë e truallit të Qytetit Studenti.

21.1 Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave e Ndërtimeve Informale, të shqyrtojë praktikën e lejeve të legalizimit nr. 20103 dhe 20104 datë 29.6.2012 për të cilat nga auditimi është konstatuar se janë lëshuar në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.4.2006 “Për

legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale” të ndryshuar, pasi dy objektet e trojet, janë brenda territorit të qytetit studenti.

22. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “*Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme*”, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor, të nxjerrë urdhër kufizimi, dhe konkretisht:

1. ZK 2884, pasuria nr. 37/3, volumi 8, faqe 1, për plotësimin e dokumentacionit në përmbushjen e detyrimeve financiare sipas shkresës së Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë (DRTT) nr. 45252/2, datë 15.8.2011 dhe nr. 47748/1, datë 24.8.2011 për objektin godinë *banimi dhe shërbimi 3-8 kat dhe 2 kate parkim nëntokë* ndryshe nga leja e ndërtimit dhe e shfrytëzimit të cilat përcaktojnë qartësisht objektin godinë banimi 3 dhe 8 kat + një kat garazh.

2. ZK 8360, pasuria nr. 2/24, volumi 1, faqe 1, për plotësimin e dokumentacionit në përmbushjen e detyrimeve financiare sipas shkresës së DRTT nr. 45252/2, datë 15.8.2011 dhe nr. 47748/1, datë 24.8.2011 për objektin godinë *banimi dhe shërbimi 3-8 kat dhe 2 kate parkim nëntokë* ndryshe nga leja e ndërtimit dhe e shfrytëzimit të cilat përcaktojnë qartësisht objektin godinë banimi 3 dhe 8 kat + një kat garazh.

3. ZK 8310, pasuri nr. N-12, volumi 22, faqe 147 për plotësimin e dokumentacionit në përmbushjen e detyrimeve financiare, pasi mungon vërtetimi për përmbushjen e detyrimeve tatimore të lëshuara nga DRT Tiranë.

23. ZVRPP Tiranë, në administrimin e dokumenteve dhe inventarëve të dosjeve të pasurive të merren masa për zbatimin e plotë të kërkesave të përcaktuara me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “*Për arkivat*” dhe Rregulloren e ZQRPP nr. 184, datë 08.4.1999, të ndryshuar.

24. Nga Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, të nxirret urdhri i brendshëm për zbatim, që në momentin e kryerjes së inventarizimit të dokumentacionit që ndodhet në referencë, të vendoset detyrimisht numri i çdo dokumenti sipas radhës në zbatim të germës “b” neni 24 dhe neneve 4 e 5, Kapitulli II-të, për “*Detyrat e Sekretar-Arkivit të organit shtetëror*” dhe “*Rregullores për punën me dokumentet administrative të organeve shtetërore*” të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “*Për arkivat*”, detyrë që të zbatohet vazhdimisht.

C. MASA DISIPLINORE

I- Mbështetur në nenet 37, 141, 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe nr. 9125, datë 29.07.2003, ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “*Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme*”, si dhe në kontratën individuale të punës, ***kërkojmë nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë***, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, për punonjësit përgjegjës si më poshtë:

C. 1. “Vërejte me paralajmërim”, për:

1. **M.G.** me detyrë inxhinier (hartograf)
2. **A.H.** me detyrë inxhinier (hartograf)
3. **E.D.** me detyrë juriste
4. **E.F.** me detyrë inxhinier (hartograf)
5. **S.A.** me detyrë juriste
6. **A.A.** me detyrë inxhinier (hartograf)
7. **B.D.** me detyrë inxhinier (hartografe)
8. **M.P.** me detyrë arkiviste
9. **S.A.** me detyrë inxhinier (hartograf)
10. **XH.V.** me detyrë inxhinier (hartografe)
11. **A.M.** me detyrë juriste

12. **L.F.** me detyrë juriste
13. **E.K.** me detyrë juriste
14. **R.D.** me detyrë juriste
15. **A.P.** me detyrë inxhinier (hartograf)
16. **E.Q.** me detyrë jurist
17. **V.D.** me detyrë inxhinier (hartograf)
18. **A.K.** me detyrë inxhinier (hartograf)
19. **R.P.** me detyrë juriste
20. **V.SH.** me detyrë jurist
21. **B.A.** me detyrë inxhinier (hartograf)
22. **B.H.** me detyrë jurist
23. **N.Z.** me detyrë inxhinier (hartografe)
24. **R.L.** me detyrë juriste
25. **G.B.** me detyrë inxhinier (hartografe)
26. **B.L.** me detyrë inxhinier (hartografe)

C. 2. “Zgjidhje të menjëhershme të kontratës individuale”, për:

1. **E.S.** me detyrë jurist
2. **A.Z.** me detyrë juriste
3. **M.M.** me detyrë juriste

-Për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 dhe nr. 33/2012, datë 29.4.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, UKM nr. 1, datë 31.07.2007 dhe UKM nr. 2, datë 12.9.2012 “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, kapitullin e I, të Udhëzimit të Kryeregjistruesit nr. 2532, datë 21.04.2009 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme...” dhe të Rregullores për Punën e ZRPP, nr. 184, datë 08.04.1999 të ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore.

-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në regjistrimin fillestar dhe veprimeve të tjera të pasurive të paluajtshme.

D. KALLËZIM PENAL

D.I Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, me shkresën nr. 577/23, datë 19.02.2014, kemi bërë kallëzim penal duke dërguar për veprime të mëtejshme procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, personat:

- 1 - **E.S.** me detyrë jurist
- 2 - **M.M.** detyrë juriste
- 3 - **E.H.** me detyrë hartografe

Për 4 raste të shkelje të procedurave ligjore e nënligjore në regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të fituar me AMTP në fshatin Pezë e Madhe, kur aktet nuk janë nënshkruar nga Kryetari i Komisionit të Ndarjes së Tokës në fshat, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar me ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012, germa “b” dhe “c” të UKM nr. 2, datë 08.4.2009 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”, dhe të Rregullores së Brendshme të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nr. 184, datë 08.04.1999.

D.II Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, me shkresën nr. 577/24, datë 19.02.2014, kemi bërë

kallëzim penal duke dërguar për veprime të mëtejshme procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, personat:

- 1 - L.K.** me detyrë ish-Përgjegjëse e Sektorit të Legalizimit të ALUIZNI Tiranë
- 2 - T.B.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës të ALUIZNI Tiranë
- 3 - M.B.** me detyrë ish-Regjistruese e ZVRPP Tiranë

Për dy praktika legalizimi nr. 20103 dhe 20104 datë 29.6.2012 për pasuritë e ndodhura në zonën kadastrale 8160, të lëshuara në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale” të ndryshuar, pasi dy objektet dhe trojet përkatëse, janë pjesërisht brenda territorit të qytetit studenti, por dhe kanë krijuar një dëm nga mosllogaritja e saktë e parcelës ndërtimore.

Për regjistrimin dhe kalimin nga sistemi hipotekor në sistemin e regjistrimit fillestar sporadik të referencës 02530 për pasurinë e regjistruar me nr. 6/242, në volum 10 faqe 165 dhe sipërfaqe trualli prej 500 m², pasi origjina e regjistrimit është në kundërshtim me ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit dhe Privatizimit të Pronës Shtetërore.

Shënim:

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, për veprimtarinë e ushtruar gjatë periudhës objekt i këtij auditimi dhe për periudhën nga data 01.01.2013 deri më 31.12.2013, do të riauditohet gjatë vitit 2014, bazuar në standardet INTOSAI, Rregulloren e Brendshme të KLSH-së dhe Vendimit të Kryetarit nr. 13, datë 28.02.2013.

Auditimi është kryer nga audituesit Qemal Shehu, Ryisim Xhaja, Halil Isufi, Brunilda Zeneli dhe Julian Adili më tej u shqyrtua nga z. Fatmir Zilja kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT